# DËSHMI ARKIVI

**A-478439**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kush do të jetë “Ergys Agasi” i ri? |
| ADRESA | `https://www.cna.al/aktualitet/kush-do-te-jete-ergys-agasi-i-ri-i475454` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 08:59:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 08:49:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `aac1917ced6792f03c34ec1af1d9326521791683587c73f1931656da5371029d` |
| TEKSTI | `9b54d97c70b7163ee75e90e3cfe45af99b3fd85a2398405cb97e17c55abba239` |
| PAMJA | `873375c5e72eed7af414a93457486b443424e32ac67e0fac3b64cea46ff31093` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `845a6fb17a9b96bc32812aa1bff38f4478e9881593ceae06121229aa3d487939` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/845a6fb17a9b96bc32812aa1bff38f4478e9881593ceae06121229aa3d487939`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

## E fundit!

x

10:49 Aktualitet

Ergys Agasi ishte një personazh jo i panjohur në qarqet po...

# Kush do të jetë “Ergys Agasi” i ri?

29 Shtator 2026, 10:49, Aktualitet CNA



Ergys Agasi ishte një personazh jo i panjohur në qarqet politike dhe të përditshmen e kryeqytetit. Shumë zyrtarë, personazhe publike, drejtorë, ministra kalonin nga zyra e tij në zonën e Bllokut në kryeqytet.

Takimet e tjera zhvilloheshin në “Equos Resort”, atje ku Agasi me lidhjet e tij sa te AKSHI, te Hipoteka, te SHISH, te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe institucionet e

tjera zhvillonte karrierën e njerëzve të tij "besnikë".

- 

### [“Në radhë për një takim me Agasin”/ Elvi Fundo zbulon “bëmat” e kabinetit të Ramës]

***Krijonte një rrjet njerëzish në administratë, por në fakt lidhjet e Ergys Agasit shkonin dhe te biznesi për të nxjerrë leje ndërtimi dhe për tu kthyer në një njeri që "fuste në borxh" biznesin apo bënte ndere me qytetarët dhe shtonte pasurinë nëpërmjet influencës dhe lidhjeve të shumëpërfolura kriminale.***

Ergys Agasi nuk është aq “fajtor”, sa ndoshta të gjithë po e rëndojnë. Fjala “gjeti shesh dhe bëri përshesh” është shumë pak në këtë rast.

- 

### [Nga buronte pushteti i Ergys Agasit?]

Atij dikush ja dha gjithë këtë pushtet. Nga emri i tij ka kaluar shkarkimi i të paktën tre ministrave dhe këtë nuk e bën dot Ergys Agasi i vetëm. Dikush duhet ta sqarojë historinë që kalon sa nga Taulant Balla te Ervin Hoxha e të tjerë.

Nuk emërohet dhe shkarkohet dot një drejtoreshë Hipoteke, një drejtor i Policisë së Shtetit, drejtoreshë e AKSHI-t, në fakt kjo e fundit ishte vendosur më para në detyrë por pati një “lidhje të fortë” korrupsioni dhe skandalesh me Ergys Agasin.

Ai shfrytëzoi sistemin dhe lidhjet e tij me kryeministrin për të shtrirë tentakulat në pushtetin e socialistëve, Rilindjes dhe 99-çave, pasi ky është trinomi i mazhorancës së sotme.

- 

### [Kush është Kryeministër në Shqipëri?]

Ergys Agasi ishte një djalë i ri që vinte nga lidhjet politike, ish-zyrtar në Ministrinë e Mjedisit në kohën që drejtohej nga Lefter Koka, djali i një zyrtari të lartë të Partisë Socialiste, si Bardhyl Agasi, që më pas u bashkua me Ilir Metën dhe zgjedhjet e vitit 2021 e në vazhdim do ta bashkonin me Edi Ramën.

Ergys Agasi shfrytëzoi institucionet, emri i tij u bë mjaft i rëndësishëm, një nga njerëzit ku mund të zgjidhje hallet dhe hallet e shumta shqiptarëve nuk iu mungojnë.

- 

### [I arrestuar dhe me akuza nga SPAK/ Kush është Ergys Agasi, lidhjet me politikën]

Por, perandoria e tij, AKSHI, Hipoteka, Policia e Shtetit, SHISH-i, tashmë është rrënuar. SHISH dhe Policia e Shtetit dy nga institucionet më të rëndësishme të sigurisë kombëtare në vend, menaxhoheshin prej tij, jo thjesht dhe vetëm me emërimin e drejtuesit por dhe me qelizat e poshtme. Siç është rasti i Policisë Shkencore.

- 

### [Skema kriminale/ Shefi i Policisë Shkencore ia kalonte informacionet Agasit]

Këto janë shumë pak për ato që janë bërë dhe kanë ndodhur me Ergys Agasin, por përgjegjësia më shumë sesa e këtij individi që ishte një biznesmen në botën e lirë, është e institucioneve të kapura, e mazhorancës dhe e kryeministrit.

***Prandaj lajmi tani nuk është më Ergys Agasi, lajmi është kush do të jetë "Ergys Agasi" i ri, sepse kryeministri jonë ka prodhuar shumë të tillë.*** I merr, i mban pranë, ata ngrihen dhe më pas bien, përfshirë këtu politikanë dhe jopolitikanë. Ergys Agasi është nga grupimi i dytë.

Dashuritë e përkohshme me individë që marrin super pushtet të Edi Ramës janë të pandalshme, ndaj lajmi i radhës duhet të jetë: ***Kush po e zëvendëson Ergys Agasin?*** **/CNA**








Të sugjeruara

## [Pse po flet Mirel Mërtiri i inceneratorëve?]

[Ja ku pritet të nisë sezoni i ri i "Të Paekspozuarit" nga Ylli Rakipi]

[Nga heqja e akcizës te nafta te rialokimi i fondeve/ Blegtorët i drejtohet qeverisë me 7 kërkesa]

[Dita e emrit të Kryepiskopit Joan/ Fortlumturia e Tij merr urime dhe vlerësime nga Primatët e lartë të Kishave]

[Ndalimi i importeve të mishit nga Brazili/ Përpunuesit paralajmërojnë rritje të çmimeve deri në 40%]

**KLSH zbulon parregullsi të rënda/ Krizë financiare te "Trajtimi i Studentëve" në Korçë**

**“O shok i Agasit”/ Fundo ia numëron socialistit: 13 vite në pushtet, e njëjta narrativë**

**Gazetari: Mazhoranca ka sulmuar drejtësinë e re për rastin e Veliajt, ka “masakruar” prokurorin Dadon**

**“Media e ka denoncuar”/ Gazetari: Rama asnjë reagim për inceneratorët, nuk mban përgjegjësi morale**

**“Në radhë për një takim me Agasin”/ Elvi Fundo zbulon “bëmat” e kabinetit të Ramës**

**Fundo i “përvishet” Klosit: Shtetit i vunë “zjarrin”, mazhoranca e Agasit**

**Gazetari "plas bombën": Ergys Agasi ishte në fushatën e PS-së në Durrës**

**Mbi 4 muaj protestë/ Qytetarët vijojnë thirrjet për dorëheqjen e Ramës**

**Shfaqet për herë të parë në publik/ Kush është kreu i komanduar i SHISH-it, Elvis Lila**

**AKSK paralajmëron qytetarët: Kujdes me llogaritë në Whatsapp, mund të humbni aksesin**

**Zjarr i madh në Memëlisht, rrezikohet zona pyjore**

**Garda pengoi gazetaren të raportonte/ Reagon AGSH: Mohim i aksesit për të ushtruar detyrën**

**Zgjerimi i BE-së/ Ndërkombëtarët: Shqipëria ka ndërmarrë hapa pozitivë**

**Anëtarësimi në BE/ Rama: Shqipëria përparësi ndaj vendeve të tjera**

**Burimas, protesta për ujin/ Banorët kundër projektit për furnizimin e Zvezdës**

## editorial

09:11 Editorial Bujar Leskaj

**Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!**

**CNA LIVESTREAM**

Na ndiqni edhe në

acromax

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.